

OLGER BRAME

**GJUHËT E FSHEHTA SI KOD KOMUNIKIMI
RASTI I PURISHTES**

Çdo individ ka mënyrën e tij të veçantë të të folurit, duke marrë parasysh që ka një pjesë të panënshtueshme të tij prej ndikimit të grupeve, të cilave ai u përket, pra ka një idiolekt. Ai mund të përdorë dialektin krahinor brenda kombit, ku sundon zyrtarisht një e folur tjetër, ose dialektin shoqëror, sistemin e shenjave dhe të rregullave sintaksore të përdorura prej një grupi të dhënë shoqëror, ose duke iu referuar atij grupi. Si pjesëtar i një grupi shoqëror-profesional, ai mund të sjellë ndryshime në leksik dhe në shqiptimin e tij, kurse kjo mund të përfundojë me një zhargon ose argo¹.

Sot termi *argo* përdoret për çdo lloj gjuhe sekrete dhe mund të quhet sociolekt i çdo grupi social, anëtarët e të cilit kanë qëllim të fshehin përmbajtjen e mesazheve, kurse *zhargoni* është një sociolekt që lidhet me një shtresë të ngushtë shoqërore a profesionale dhe që është i pakuptueshëm nga shtresat e tjera. Edhe argotë edhe zhargonet janë të pakuptueshme nga grupet e tjera shoqërore dhe të dyja mbështeten në strukturën gramatikore të gjuhës brenda të cilës jetojnë, por ndërsa të parat mbështeten në fjalët e gjuhës së zakonshme duke u ndryshuar formën fonetike ose kuptimin, zhargonet kanë leksikun e vet².

Nga studimet etnolinguistike dhe sociolinguistike, dihet se në shumë bashkësi gjuhësore, krahas varieteteve të zakonshme e të përdorshme përditë nga të gjithë anëtarët e një bashkësie gjuhësore të dhënë, janë përdorur edhe një a shumë varietete, që kanë një numër të kufizuar përdoruesish dhe karakter mjaft artificial³. Në këtë kuadër përfshihen të ashtuquajturat të folme a gjuhë të fshehta, gjuhë speciale, të cilat janë si të folme, përdoren brenda një bashkësie të caktuar gjuhësore dhe kanë funksion kryesisht shoqëror. Këto të folme janë një kod i rëndësishëm komunikimi brenda atij grupi shoqëror që e përdor këtë kod.

Kur merremi me komunikimin, fjalës **kod** si term, meqenëse është një fjalë polisemike, në aspektin komunikues, mund t'i nxirret më qartë kuptimi, duke iu referuar termit **kodim**. Kështu kodimi është vënia në veprim e një kodi. Nganjëherë kodimi shënon veprimin që sjell zëvendësimin e sinjaleve, të cilat i përkasin një sistemi të caktuar, me sinjale që i përkasin një sistemi

¹ Ch. Baylon & X. Mignot, *Variacioni shoqëror i komunikimit*, në *Komunikimi*, Logos –A, Shkup, 2004, f. 187-188

² R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, 2006, f. 319-320.

³ Gj. Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, 2004, f. 194.

tjetër. Në këtë kuptim kalohet nga një mesazh tashmë i ndërtuar, përgjithësisht një tekst, te një mesazh tjetër. Kjo është gjuha e përditshme dhe mbështetet një njërën prej domethënieve të termit kod. Kur flitet për mesazh të koduar, do të thotë se i drejtohem një kodi të fshehtë. Atëherë kemi të bëjmë me një mesazh që është bërë i pakuptueshëm, sepse sinjalet e tekstit fillestar, që mund të rrokeshin nga çdo njeri që njeh gjuhën përkatëse, janë zëvendësuar me sinjale të reja, të pakuptueshme për ata që nuk i dinë⁴.

Joshua Fishman thekson se një kod lidhet me një fushë më shumë se kodi tjetër dhe se kjo lidhet edhe nga mosha. Ai vlerëson se folësit e një gjuhe “krijojnë shprehi” që kur të flasin për një temë të caktuar, të shfrytëzojnë një kod të caktuar dhe kjo bëhet për disa arsye⁵.

Në këtë pikëvështrim, të folmet e fshehta përjashtojnë nga komunikimi, atë pjesë përdoruesish të gjuhës së përditshme natyrore, që nuk është e aftë të zbërthejë kodin e kësaj të folmeje, duke e duke përjashtuar në këtë mënyrë nga komunikimi pjesën tjetër, që nuk është njohëse e kodit. Këto të folme janë të përdorshme vetëm nga një numër i caktuar përdoruesish, të cilët kanë si qëllim, kryesisht, mbajtjen fshehtë të mjeshtërisë ose për të mos u kuptuar nga të tjerët në një situatë të caktuar komunikuese.

Gjuhët e fshehta dhe gjuhët e krijuara në bazë të lojërave me fjalë nuk janë të panjohura në botë. Sipas Fromkin et al, këto gjuhë shfrytëzohen ose si mjet për t’u identifikuar si grup i posaçëm, si mjet për argëtim, siç është rasti i elfishtes në trilogjinë “Zoti i Unazave”, ose për t’i penguar të tjerët të marrin vesh atë që po flitet⁶.

Brenda këtij kuadri duhen parë edhe të folmet e fshehta në gjuhën shqipe, të cilat funksionojnë si mënyra komunikimi të veçanta brenda një krahine apo zone të caktuar. Ato funksionojnë krahas gjuhës së shkruar dhe ligjërit, si dhe dialekteve. Nga ana tjetër duhet theksuar fakti se gjuhët e të folmet e fshehta, megjithëse veprojnë brenda një zone të caktuar, nuk janë pronë e të gjithë banorëve të zonës a krahinës, por e asaj pjese që e përdor këtë “gjuhë” për një qëllim të caktuar.

Pikërisht, shtrirja vetëm brenda një grupi të caktuar shoqëror, përbën edhe të veçantën e këtyre të folmeve, të etiketuara si **të folme shoqërore**. Si shfaqje individuale, këto të folme përbëjnë një kodim, i cili realizohet me anë të marrëveshjes që bëhet brenda grupit shoqëror me një synim të caktuar. Karakteristike për këto të folme, mbetet fshehtësia, gjë që sjell si rezultat

⁴ Shih: Ch. Baylon & X. Mignot, *Komunikimi*, Logos –A, Shkup, 2004, f. 24-25

⁵ J. A. Fishman, *The Relationship between Micro- and Macro-Sociolinguistics në Study of Who Speaks What Language to Whom and When*, Sociolinguistics, Penguin Books, 1979.

⁶ V. Fromkin, R. Rodman, N. Hyams, *An Introduction to Language*, Heinle, Boston, 2003

pakuptueshmërinë dhe pazbërthyeshmërinë e tyre, për të gjithë ata që nuk janë pjesë e grupit përkatës shoqëror. Kjo është dhe arsyeja kryesore që termi më i përshtatshëm për të emërtuar këto të folme është **të folme të fshehta**.

Studimet e të folmeve shoqërore në gjuhën shqipe kanë nisur herët. Që më 1942, Eqrem Çabej ka pasur një studim rreth elementeve të shqipes që kanë hyrë në të folmet e zejtarëve të Greqisë Veriore. Mirëpo, si studim më i plotë dhe me analizë më të hollësishme në këtë aspekt, mund të konsiderohet artikulli “Të folmet shoqnore” i Qemal Haxhihasanit, i botuar në revistën “Studime Filologjike” më 1964/1. Në këtë punim autori shkruan për “*nji tog të folmesh e mënyrash të veçanta komunikimi, të cilat njihen me emna të ndryshëm sipas krahinave, rretheve shoqnore, grupeve profesioniste që i kanë përdorë*”⁷. Ai përmend purishten si të folme të muratorëve të Oparit (Korçë), dogançen e kallajxhinjve të Brezhdanit, të Malëshovës e të Limarit, lovidharçen e sharraxhinjve të Kaludhit, të Konikolit, delipbepçen e belaxhinjve të Tiranës etj.

Punimi ynë u realizua në terren ku u mundësua edhe regjistrimi gjuhësor i materialit në këndvështrimin sociolinguistik për studimin e gjuhës së fshehtë të muratorëve në zonën e Oparit në Korçë, e njohur ndryshe si “purishtja”. Gjatë regjistrimit u organizuan edhe pyetje në formë interviste të cilat konsistonin në elemente të tilla si: niveli i njohjes së purishtes, kohën dhe situatat kur e kanë mësuar, situatat në të cilat e përdorin, etj.⁸

Gjatë regjistrimit u bë e mundur edhe vjelja e materialit leksikor, ku janë klasifikuar rreth 30 fjali si dhe është bërë një ndarje e materialit leksikor sipas përkatësisë së pjesëve të ligjëratës, i cili është afërsisht një fond prej 100 fjalësh. Në pjesën më të madhe fjalët lidhen me procese komunikimi në punë dhe në situata familjare. Duke analizuar përgjigjet e pyetjeve rezultojnë se:

Pure – do të thotë usta, murator.

Purishte – e folura e muratorit, gjuha e ustait e cila flitet në Oparin e Sipërm.

Purishtja, si e folme, është mësuar që në fëmijëri, kryesisht nga vetë prindërit. Ajo flitet gjithnjë e më rrallë, përgjithësisht nga brezi më i vjetër. Të rinjtë nuk e flasin në mënyrë të plotë për të komunikuar mes tyre, por përdorin fjalë a fraza të shkëputura prej saj. Rastet kur kjo e folme i mësohet brezit të ri janë të rralla dhe përgjithësisht lidhen me mjedisin brenda familjes. Duke qenë se si e folme ka pasur lidhje me profesionin, sot ajo po përdoret gjithnjë e më rrallë, sepse ka ndryshuar edhe situata me të cilën lidhej përdorimi i saj. Përsa i takon kësaj të fundit, mund të evidentohen këto situata përdorimi të purishtes:

⁷ Q. Haxhihasani, *Të folmet shoqnore*, në “Studime filologjike”, Tiranë, 1964/1, f. 99-128.

⁸ Për regjistrimin e materialit falënderojmë N.M., 67 vjeç, banor i fshatit Lekas, Opar-Korçë.

- a-** Për të mos u kuptuar nga të tjerët
U lodh rojku. (Erdhi i zoti i shtëpisë).
Rojku është domushar. (I zoti i shtëpisë është i pasur).
- b-** Për të zbutur një kërkesë ose kur druan të thuash diçka
A më lodh ca të trëme? (A më jep ca lekë hua?)
- c-** Për të shprehur një ndjenjë të caktuar
Ç'ke që zburren? (Pse qesh?)
- d-** Në situata humori
Qënka fyk, po dhe bërës. (Qenka plak, por edhe qejfli.)
- Materiali leksikor i vjelë:
- 1. Puret mbetën pa kronjë si i zuri mushafi*
Ustallarët mbetën pa punë sepse nuk gjenin.
 - 2. Puret zhavluan në qoj dhe polanisën kronjë dhe tymës.*
Ustallarët shkuan në fshat dhe kërkuan bukë dhe duhan.
 - 3. Kjo lukur vazhdon disa sotje.*
Kjo punë vazhdon disa ditë.
 - 4. Rojku u lodhi pureve kronjë dhe tymës në domë.*
I zoti i shtëpisë u dha ustallarëve bukë dhe duhan në shtëpi.
 - 5. Purja u lodh te rojku dhe pajti një lukur të gruthme.*
Ustai shkoi te i zoti i shtëpisë dhe mori(pajtoi) një punë të paguar mirë.
 - 6. Rojku ishte domushar dhe filelli.*
I zoti i shtëpisë ishte i pasur dhe i mbante me ushqim të mirë/u jepte ushqim të mirë.
 - 7. Krezhdën e kishte shumë të gruthme për lukurën e domës.*
Gruan e kishte shumë të mirë /të zonjën, për punët e shtëpisë.
 - 8. Rojku kishte pesë çardakë; dy bimëza dhe tre çipuj.*
I zoti i shtëpisë kishte pesë fëmijë; dy vajza dhe tre djem.
 - 9. Puret drunjasën pranë një çakalli, se i zuri e errëta.*
Ustallarët fjetën pranë një shkëmbi sepse i zuri nata.
 - 10. Çipuli ishte i spalur e nuk polaniste për të kreur kronjë.*
Djali ishte i sëmurë dhe nuk kërkonte për të ngrënë.
 - 11. Rasti dhe krezhda zhavluan për të lukurosuar saçmallin.*
Burri dhe gruaja shkuan për të punuar/prashitur misrin.
 - 12. Purja u lodh në domë me të majkos.*
Purja erdhi në shtëpi me torbën e veglave të punës.
 - 13. Rojku e kishte domën me skoro të sprapsur ku hynte dápillo e bárdhi.*
I zoti e kishte shtëpinë me mure të prishur ku hynte shiu e bora.
 - 14. Krezhda e domësi lukuret gruthëm snakët me llápte e líko.*
Zonja e shtëpisë i gatuate shumë mirë lakrorët me dhallë e djathë.
 - 15. Bimëza zburrente me sllamat e frates së vogë.*
Vajza qeshte me gënjeshtat e vëllait të vogël.
 - 16. Roku kishte një kráckë të gruthme.*
Zoti i shtëpisë kishte një raki të mirë.
 - 17. Krezhda e domës ishte e fykur, po bimëza dhe strínxia ishin të gruthme.*

Zonja e shtëpisë ishte e plakur, por vajza dhe nusja ishin të mira /të reja.

18. *Strínxia e zhvati çipulin se polaniste kráckë.*

Nusja e rrahu djalin e vogël sepse kërkonte të pinte raki.

19. *Bimëza e rojku ishte e fandrëpsur. Kakampërri ishte një rast i mbëshëm.*

Vajza e të zotit të shtëpisë ishte e martuar. Dhëndëri ishte një burrë i bëshëm/shëndetshëm.

20. *Rojku na priti me kërne e mbytye.*

I zoti i shtëpisë na priti me mish e bakllava. (Na priti mirë)

21. *Behe, behe, rojku na priti me frençka.*

Shiko, shiko, i zoti i shtëpisë na priti me fasule. (Nuk na priti mirë)

22. *U xhuxhos rojku me një bimëz të gruthme.*

U martua i zoti i shtëpisë me një vajzë të bukur.

23. *Zdëc se po lodhet rojku me krezhdën.*

Pusho se po vjen i zoti i shtëpisë me të shoqen.

24. *Xhyxhasi rojku çipulin e nuk therri një brryle.*

Martoi i zoti i shtëpisë djalin e nuk theri një dele.

25. *Purja di vetëm monokap e ligur të të lyermes.*

Ustai di vetëm çekan dhe mistri.

26. *S'bëhet skoro pa shaulle zigëz.*

S'bëhet muri pa plumbçe e nivel.

27. *Është domushar, po nuk i çkulet gjë.*

Është i pasur /ka para, por nuk i lëshon dora.

28. *Rojku i ka t'Miços si bisht llogu.*

I zoti i shtëpisë i ka mustaqet si bisht kali.

29. *Kaplla e rojku si angone e skoros.*

Koka e të zotit të shtëpisë si qoshja e gurit në mur.

30. *Puret zhavluan se rínë tabok me rojkun për shticat lemeje.*

Ustallarët u larguan sepse bënë sherr me të zotin e shtëpisë për rrasat e gurit.

Nga analizimi që mund t'i bëhet materialit të listuar konstatohet se ndeshim përgjithësisht dy situata: situata që kanë të bëjnë me jetën në familje si gatimi, punët e shtëpisë, pasuria, martesat etj. dhe situata që kanë të bëjnë me punën dhe procese të saj nga ana e ustallarëve (pureve).

Nëse i bëjmë një kategorizim materialit për nga përkatësia leksikore (shih në fund të punimit), vihet re se pjesa më e madhe e tij janë emra, më pas folje e mbiemra. Pjesët e tjera të ligjëratës, parafjalë, pjesëza, lidhëza, ndajfolje etj., kryesisht futen në ligjërim nga gjuha shqipe duke u kombinuar me elemente të purishtes.

Përfundime

Purishtja si e folme e fshehtë, në aspektin e komunikimit, ka filluar të humbasë përdorimin e saj. Shkaku kryesor lidhet fillimisht me kushtet e reja shoqërore, të cilat kanë sjellë rrethana të tilla që nevoja për përdorimin e saj në komunikim ka filluar të zbehet e pse jo të shkojë drejt zhdukjes.

Duke iu referuar aspektit sociolinguistik, mund të thuhet se përdoruesit e purishtes, si pjesë e një subkulture, kanë filluar të humbasin kontaktet me të, sepse kanë krijuar kontakte më të ngushta me një subkulturë tjetër, në rastin tonë të folmen krahinore a dialektin e zonës ku jetojnë, ose me kulturën, në rastin tonë standardin e gjuhës shqipe, të detyruar edhe nga faktorë që kanë të bëjnë me migrimet tyre në zona të ndryshme në Shqipëri.

Gjithsesi, në kuadrin e ekzistencës si variant gjuhësor dhe kod komunikimi, ajo ka lindur për shkak të kushteve të punës së muratorëve, me qëllim për të mos u kuptuar nga marrës të mesazhit që nuk e deshifrojnë këtë lloj kodimi.

Është një e folur që kryesisht është përdorur nga burrat (ustallarët).

Situatat kryesore ku është përdorur ajo kanë të bëjnë:

a-Për të mos u kuptuar nga të tjerët

b-për të bërë kërkesa midis pureve në mënyra të zbutura.

c-për humor midis pureve (nofka të zotit ku punonin, nofka njëri-tjetrit, për të shprehur ndjenja të caktuara si zemërim, inat etj.).

Purishtja ka në një leksik të pasistemuar, i cili përfshin fjalë të shqipes, fjalë të krijuara në bazë të ngjashmërive, metaforës, shkëmbimit të tingujve, si dhe një pjesë fjalësh të huazuara nga gjuhë të ndryshme. Shumësi i emrave ndjek pothuaj të njëjtën rrugë formimi si në shqip, me prapashitesat trajtëformuese përkatëse; **k-q** (rajk-rajq), **l-j** (çipull- çipuj) etj.

Sintaksa e fjalisë i përgjigjet rregullave sintaksore të gjuhës shqipe, përsa i përket rendit të fjalëve. Në fjali futen edhe folje, mbiemra, numërorë, pjesëza, përemra të pacaktuar në gjuhën shqipe, të cilët nuk kanë gjegjëset e tyre në purishte. Një pjesë e mirë e fjalëve janë krijime bazuar në kuptimet e fjalëve në shqip, kryesisht formime në bazë ngjashmërie ose kalim kuptimi, të tilla si:

Këmbë- shkelje (nga shkel)

Dëborë – i bardhi (nga e bardhë)

Ditë – sotje (nga sot)

Natë – E errëta (nga e errët, errësirë)

Misër – Saçmalli (nga saçmë; ngjashmëria e kokrrës së misrit me saçmën)

Vajzë beqare- bimëz (nga bimë e re, diçka e brishtë)

Duhan – tymës (nga tymi që nxjerr duhani)

Qepë – djegës (nga cilësia e qepës që djeg) etj.

Fjalët e krijuara janë të kufizuara vetëm në disa fusha të caktuara, duke u plotësuar me huazime nga gjuhë të tjera si:

Domë -dom (shtëpi) – rusisht

Zige- dhi –gjermanisht

Frate – vëlla- latinisht

Llog- kalë- greqisht

Pethanos-vdes-greqisht

Qiraçka –qersh (qerazia)-greqisht

Glinë- pulë –rumanisht
Kërne-mish-rumanisht
Sare - kripë –arumanisht
Kaplla-kokë –arumanisht
Tosere- sëpatë –sllavishtja etj.

Faktin që një pjesë e mirë e leksikut të purishtes ka fjalë nga arumanishtja, studiuesi Gj. Shkurtaç e shpjegon me faktin që duke qenë një zonë kufitare me zonën e Voskopojës, e cila ka popullsi të konsiderueshme vllehe, kjo ka ndikuar në leksikon të purishtes me fjalë nga arumanishtja.

Duke iu përmbajtur këtij argumenti, përjasja që mund të bëhet në rastin e purishtes mund të jetë e përafërt me atë të formimit të gjuhëve pishine, si gjuhë hibride, të dalë nga përzierja e dy a më shumë gjuhëve, por, në rastin tonë, ndryshimi qëndron në faktin se purishtja nuk ka lindur në situata kur folës me gjuhë amtare të ndryshme ndiejnë nevojën për të komunikuar mes tyre, por për të fshehur mesazhet e shkëmbyera mes tyre. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin që brenda bashkësive, të cilat mund të jenë gjuhësisht homogjene, është normale bashkëjetesa e njëkohshme e kodeve të ndryshme gjuhësore brenda të njëjtës territor ose të njëjtës bashkësi gjuhësore.

Nga ana tjetër ashtu si gjuha pishine nuk ka folës amtare, kjo vlen edhe për purishten, e cila shërben vetëm si mjet ndihmës apo shtesë në komunikimin midis individëve apo bashkësive të ngushta. Dallimi tjetër që duhet theksuar në këtë rast lidhet me faktin se individët apo bashkësitë i përkasin një gjuhe amtare, shqipes, dhe jo gjuhëve të ndryshme. Edhe në aspektin leksikor mund të gjenden pika takimi, sepse në të dy rastet haset një leksik i kufizuar.

Në përfundim mund të thuhet se, megjithëse nuk mund të flitet për një hulumtim të plotë e të thelluar, nga ajo çka është vjelë e analizuar, mund të thuhet se kjo “gjuhë” e fshehtë po vjen duke u zhdukur në ditët e sotme, argument i cili mund të mbështetet edhe nga fakti tjetër se kushtet e sotme social-ekonomike e kanë zhdukur dukurinë e lëvizjes së muratorëve të kësaj zone në zona të tjera brenda vendit, siç ka qenë karakteristikë tipike e dikurshme.

BIBLIOGRAFI

- A. Fishman, *The Relationship between Micro- and Macro-Sociolinguistics* në *The Study of Who Speaks What Language to Whom and When*, Sociolinguistics, Penguin Books, 1979.
- Ch. Baylon & X. Mignot, *Variacioni shoqëror i komunikimit*, në *Komunikimi*, Logos –A, Shkup, 2004, f. 187-188.
- Gj. Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, 2004, f. 194.
- Q. Haxhihasani, *Të folmet shoqnore*, në “Studime filologjike”, Tiranë, 1964/1.
- R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, 2006, f. 319-320.
- Shih. Ch. Baylon & X. Mignot, *Komunikimi*, Logos –A, Shkup, 2004, f. 24-25.

V. Fromkin, R. Rodman, N. Hyams, *An Introduction to Language*, Heinle, Boston, 2003.

Emra		Folje
bardhi-borë bimëz-vajzë çakall-shkëmb çardak-fëmijë çipul –djalë çomaks-ushtar dapllo-shi djegës-qepë domë-shtëpi e errëta-natë e misirit-oriz e zvezdës-gëlqere fele-gjellë filelli- ai që gatuan mirë fok-zjarr frençka-fasule fyk –plak; baba fyke-plakë; nënë gabzi-polic grene-grurë kafe-e zezë kakampërr-dhëndër kaplla-kokë kernë-mish krackë-raki krezhdë-zonja e shtëpisë kronjë-bukë laksho-ujë líko –djathë llapte e gruthme-qumësht llapte-dhallë lukur-punë mbytje-bakllava mere-mollë pure-usta qiracka-qershí qoj-fshat rast-burrë	rojk- zoti i shtëpisë saçmalli-misër sare-kripë shkelje-këmbë skora –mur sllame-gënjeshër snak-lakror,byrek sotje-ditë strinxë-nuse t’lepurit-veshë t’miços-mustaqe treme-lekë tymës-duhan vutur-vaj	beh-shiko çkul-shkëput drynjas-fle kre- ha; pi lukuros-punoj mzhyqen-ik me shpejtësi pllëne-qaj polanis-kërkoj prthanos-vdes rine tabok-bëj sherr shkul-vjedh shticos-mbuloj çatinë u lodh-erdhi xhvat-rrah xhyxhos-martoj zburrem –qesh zdëc-pusho zhavlon-ikën, largohet
	Emra veglash pune	Mbiemra
	angone-qoshe guri cat-çati e majkos-torbë veglash pune gletë-daltë ligur e të lyemes-mistri monokap-çekan qyf- ena që mban baltë shaull-plumbçe shtice lemeje-rrasë guri tales-sqepar tosere-sëpatë zigëz-nivel	
	Emra kafshësh	
	bed-mushkë bralovic-lopë brryle –dele glinë-pulë kcáf-qen keltushe-mace llog-kalë sperre-gomar zige-dhi	domushar-i pasur e pllatur- e paguar mirë flluq- e papaguar i, e fykur- i, e plakur i, e sparcur- i, e çmendur i,e gruthme- i. e mirë i.e fandrepsur- i, e martuar mbeshëm- i madh; i rëndësishëm nigz-i vogël vasaol- i sëmurë